



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 30.01.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit **Akil Kulla**, akuzuar për kryerjen e veprave penale: *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”* për sigurimin, magazinimin, modifikimin dhe rregullimin me qëllim shitjen kundrejt fitimit të armëve dhe pjesëve të tyre dhe gjetjes së tyre në sasi mjaft të mëdha në ambjentet në zotërim të tij dhe të të pandehurit Sokol Xhura, sipas paragrafëve 6, 7 dhe 8 të nenit 278 të Kodit Penal, të kryer në bashkëpunim në formën e “Grupit të strukturuar kriminal” me të bashkëpandehurin Enver Jamaku dhe të pandehurin Sokol Xhura, të parashikuara nga nenet 278/6, 278/7 278/8, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal; -Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279/1 i Kodit Penal, për mbajtjen e dy thikave, të cilat plotësojnë kushtet e armëve të ftohta, prerëse me tel.
2. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Atalanta Zeqiraj, Flora Hajredinaj dhe Rudina Palloj, me vendimin Nr. 36 datë 12.06.2024, vendosi:
 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Akil Kulla** lidhur me veprën penale *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”* kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278/6 në lidhje me nenet 28/4, 334 pika 1 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.
 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Akil Kulla** lidhur me veprën penale *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”* parashikuar nga neni 278/7 i Kodit Penal, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të

- grupit të strukturuar kriminal, në lidhje me nenet 28/4, 334 pika 1 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 12 (*dymbëdhjetë*) vjet burgim.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Akil Kulla** lidhur me veprën penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278/8, në lidhje me nenet 28/4, 334 pika 1 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 6 (*gjashtë*) vjet burgim.
 4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Akil Kulla** lidhur me veprën penale “*Grup i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 2 (*dy*) vjet burgim.
 5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Akil Kulla** lidhur me veprën penale “*Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta*” parashikuar nga neni 279/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (*gjashtë*) muaj burgim.
 6. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve në një të vetëm duke u dënuar i pandehuri **Akil Kulla** me 13 (*trembëdhjetë*) vjet burgim.
 7. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të K.Pr.Penale, ulet 1/3 e masës së dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri **Akil Kulla** me 8 (*tetë*) vjet e 8 (*tetë*) muaj burgim.
 8. Referuar ligjit nr.81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, vuajta e dënimit për të pandehurin **Akil Kulla** fillon nga dita e ekzekutimit e vendimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.
 9. Shpenzimet gjatë fazës së hetimit paraprak dhe ato të gjykimit të kryera lidhur me të pandehurin Akil Kulla i ngarkohen atij.
 10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve, nga e nesërmja e marrjes dijeni lidhur me vendimin e arsyetuar.

Tiranë, më datë 12.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar